



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. 36, datë 12.05.2020

**PËR
MIRATIMIN E PËRLLOGARITJES SË VLERËS MESATARE TË MASËS SË
GRANTIT TË RIKONSTRUKSIONIT OSE RIPARIMIT PËR NIVELIN E DËMIT DS1,
DS2, DHE DS3, PËR BANESAT E DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26.11.2019
NË QYTETIN E DURRËSIT**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Akti Normativ nr.9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimet njerëzore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.282, datë 9.4.2020 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.5, datë 6.1.2020 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” si dhe çmimet e punimeve të ndërtimit në fuqi të miratuara me UKM Nr.3, datë 28.12.2016 për qytetin e Durrësit të dërguara nga Enti Kombëtar i Banesave, dhe sipas relacionit të hartuar nga Zyra e Posaçme e



Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Publike në Bashkinë Durrës, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :


1. Miratimin e përlllogaritjes së vlerës mesatare të masës së grantit të rikonstruksionit ose riparimit për nivelin e dëmit DS1, DS2, dhe DS3, për banesat e dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 në qytetin e Durrësit si më poshtë vijon:
 - a. Miratimin e përlllogaritjes së vlerës mesatare të masës së grantit të rikonstruksionit ose riparimit për nivelin e dëmit DS 1 = 750 lekë/m².
 - b. Miratimin e përlllogaritjes së vlerës mesatare të masës së grantit të rikonstruksionit ose riparimit për nivelin e dëmit DS 2 – 2000 lekë/m².
 - c. Miratimin e përlllogaritjes së vlerës mesatare të masës së grantit të rikonstruksionit ose riparimit për nivelin e dëmit DS 3 = 4000 lekë/m².
2. Miratimin e vlerës së grantit të rikonstruksionit e ndarë sipas tipologjisë së kateve si më poshtë:
 - a. Nga kati zero (Kuota e ashensorit) deri në katin e pestë teknik marrin 100% të vlerës së grantit.
 - b. Nga kati i gjashtë teknik e sipër marrin 60% të vlerës së grantit.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi administrata e Bashkisë Durrës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 12.05.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 427 Prot.
4

Durrës, më 13.05.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS ✓

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 36, datë 12.05.2020 “Për miratimin e përlogaritjes së vlerës mesatare të masës së grantit të rikonstruksionit ose riparimit për nivelin e dëmit DS1, DS2, dhe DS3, për banesat e dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 në qytetin e Durrësit”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që më jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

